



***Doracak për verifikimin e
programeve të veçanta për
arsimimin e të rriturve***



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

Dhjetor 2011

Përmbajtja

1. Qëllimi i doracakut	3
2. Ligjet dhe aktet nënligjore	3
3. Процесот на верификација на посебните програми за образование на возрасni	5
3.1. Dorëzimi i kërkesës për verifikim të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve	5
3.2. Evaluim i programit të veçantë për arsimimin e të rriturve	6
3.3. Miratimi i vendimit për verifikim të programit të veçantë za për arsimimin e të rriturve	7
3.3.1. Mbikëqyrje nga ana e IP Qendra për arsimimin e të rriturve dhe tërheqje e vendimit për verifikim të programit të veçantë	7
3.3.2. Lajmërim i entit/institucioni për arsimimin e të rriturve	8
4. Realizim i verifikimit të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve	9
5. Procesi i aplikimit dhe plotësim i kërkesës për verifikim edhe të modelit për program të veçantë për arsimimin e të rriturve	9
5.1. Model i programit të veçantë për arsimimin e të rriturve	10
6. Shtojca	14
6.1. Shtojca 1: Definimi i kuptimeve	14
6.2. Shtojca 2: Modeli i programit të veçantë për arsimimin e të rriturve	17



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE – SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

1. Qëllimi i doracakut

Qëllimi i doracakut për verifikim të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve është që t'ju ndihmojë, drejtojë dhe t'i përkrahë entet dhe institucionet për arsimimin e të rriturve në procesin e verifikimit të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve të cilat dërgojnë drejt kualifikimeve profesionale. Në fazën e parë të verifikimit do të verifikohen vetëm programe të veçanta për arsimimin e të rriturve të cilat dërgojnë drejt kualifikimeve profesionale, kurse në fazën e dytë, do të përfshihen edhe programe të veçanta për arsimimin e të rriturve të cilat dërgojnë drejt kompetencave

2. Ligjet dhe aktet nënligjore

Për verifikim të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve vlen:

- Ligji për arsimimin e të rriturve (Gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë nr.7/08, 17/11, 51/11);
- Rregullorja për përmbajtjen dhe formën e dokumentacionit dhe evidencës të cilën e udhëheqin entet dhe institucionet për arsimimin e të rriturve;
- Rregulloren për emrin, përmbajtjen dhe formën e certifikatës për njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e aritura nga programet e veçanta për arsimimin e të rriturve;
- Rregullorja për mënyrën dhe formën e udhëheqjes së regjistrit qendror dhe atij komunal për institucionet dhe entet të cilat realizojnë programe për arsimimin e të rriturve (Gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë nr. 37/10);
- Rregullorja për mënyrën e verifikimit të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve (akt i brendshëm, i miratuar nga këshilli drejtues);

të caktuara. Në tekstin e mëtutjeshëm do të përdoret vetëm termi programe të veçanta për arsimimin e të rriturve, por që do të jetë për programe të veçanta për të rritur që dërgojnë drejt kualifikimeve profesionale. Doracak, kërkesa për verifikim, si edhe dokumentet tjera të nevojshme për verifikim të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve mund t'i gjeni në faqen zyrtare të IP Qendra për arsimimin e të rriturve: www.cov.gov.mk. Të gjitha pyetjet tjera për verifikim të programeve të veçanta mund të dërgohen në adresën si vijonë: contact@cov.gov.mk.

- Rregullorja për përmbajtjen, formën dhe procesin e nënshkrimit të marëveshjes për ndjekjen e programit për arsimimin e të rriturve (miratuar nga drejtori i Qendrës për arsimimin e të rriturve);
- Rregullorja për standardet, hapësirën dhe pajisjet e enteve dhe institucioneve për arsimimin e të rriturve (miratuar nga ministri për arsim dhe shkencë), si edhe dispozitat e Ligjit për arsim fillor, Ligjit për arsim të mesëm, Ligjit për trajnim dhe arsim profesional, Ligjit për arsim sipëror dhe dispozitat dhe aktet nënligjore të cilat i rregullojnë standardet për hapësirën dhe pajisjet për arsimin fillor, të mesëm, sipëror dhe normat për mjete mësimore dhe mjete ndihmëse për drejtimet e arsimit profesional katërvjeçar.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

Programet e veçanta për arsimimin e të rriturve sipas nenit 18 të Ligjit për arsimimin e të rriturve (Gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë nr. 7/08) janë programe për:

- Arsimit të banorëve,
- Gjuhë amëtare dhe gjuhë të huaj,
- Parakualifikim,
- Mbikualifikim,
- Aftësi ndërmarëse dhe menaxhment,
- Teknologji informative dhe komunikuese,
- Shprehje kreative dhe pjesëmarrje në evenimente kulturore dhe artistike,
- Mbrojtje dhe rruajtje e ambientit,
- Shkathtësi të posaçme sociale,
- Qytetarizëm aktiv,
- Njohuri themelore nga shkenca dhe teknologjia; dhe
- Njohuri, shkathtësi dhe aftësi të tjera

Qendra për arsimimin e të rriturve do të verifikojë programe të veçanta për arsimimin e të rriturve të cilat dërgojnë drejt kualifikimeve profesionale në pajtim me Klasifikimin kombëtar të profesioneve nga viti 2011 (programe të vendosura në faqen e internetit të Entit shtetëror për statistikë (www.stat.gov.mk), për këto sfera:

- Drejtimi ekonomik – juridik dhe tregtar
- Drejtimi shëndetësor
- Drejtimi për përpunimin e tekstit dhe lëkurës
- Drejtimi grafik
- Drejtimi elektroteknik
- Drejtimi për shërbime personale
- Drejtimi hotelierik dhe turistik
- Drejtimi i pylltarisë dhe përpunimit të drurit
- Drejtimi i ndërtimtarisë dhe gjeodezisë
- Drejtimi i buqësisë dhe ai i veterinës
- Drejtimi i komunikacionit
- Gjimnazi sportiv
- Drejtimi gjeologjik, i minierave dhe i metalurgjisë
- Drejtimi kimi-teknologji
- Drejtimi maqinerik



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE – SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

3. Procesi i verifikimit të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve

Ekzistojnë katër faza kryesore në procesin e verifikimit, edhe atë:

- Dorëzimi i kërkesës për verifikim;
- Evaluimi i programit të veçantë;
- Miratimi i vendimit për verifikim të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve dhe
- Mbikëqyrja.

3.1. Dorëzimi i kërkesës për verifikim të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve

Entet dhe institucionet për arsimimin e të rriturve të cilët dëshirojnë të realizojnë programe të veçanta të verifikuara për arsimimin e të rriturve duhet paraprakisht të njihen me procedurën për verifikim nëpërmjet këtij doracaku dhe programit model për programe të veçanta për arsimimin e të rriturve, të cilat janë të vendosura në faqen zyrtare të Qendrës për arsimimin e të rriturve: www.cov.gov.mk.

Enti/institucioni për arsimimin e të rriturve, për verifikimin e programit të veçantë për arsimimin e të rriturve duhet që deri të Qendra për arsimimin e të rriturve, personalisht ose me anë të postës t'i dorëzojë këto dokumente:

- Kërkesë të plotësuar për verifikim të programit të veçantë, e cila është e vendosur në faqen e internetit të Qendrës për arsimimin e të rriturve;
- Dokument për veprimtari të regjistruar, të lëshuar nga Regjistri qendror i R. së Maqedonisë;
- Programi i veçantë në tre ekzemplarë, i përpunuar në pajtim me modelin e programit të veçantë për arsimimin e të rriturve, i cili është i vendosur në faqen e internetit të Qendrës për arsimimin e të rriturve;
- Fletëpagesë për pagesë të kryer të taksës për verifikim të programit të veçantë, në llogari të Qendrës për arsimimin e të rriturve, në pajtim me çmimoren për verifikim të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve, të cilin e sjell këshilli drejtues dhe është i vendosur në faqen e internetit të Qendrës për arsimimin e të rriturve.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

Pas pranimit të dokumentit për verifikim të programit të veçantë, IP Qendra për arsimimin e të rriturve i shqyrton dokumentet e dorëzuara dhe kontrollon a janë të gjitha dokumentet të kompletuara, a janë përdorur formularët e Qendrës për arsimimin e të rriturve për verifikim të programeve të veçanta dhe na bazë të kësaj sjell vendim, se a do t'i jepen dokumentet, Komisionit për verifikim ose do t'i kthehen entit/institucionit për arsimimin e të rriturve. Në rast se dokumentet nuk janë të plota, gjegjësisht nuk janë të kompletuara, lajmërohet enti/institucioni për arsimimin e të rriturve, që të

dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm shtesë. Enti/institucioni duhet që në afat prej 8 ditësh, të kompletojë dokumentet dhe t'i dërgojë deri te Qendra për arsimimin e të rriturve.

Në afat prej 30 ditësh, nga dita e dorëzimit të dokumentacionit të kompletuar deri të Qendra për arsimimin e të rriturve, bëhet shqyrtimi dhe evaluimi i programit të veçantë, të dorëzuar, për arsimimin e të rriturve.

3.2. Evaluimi i programit të veçantë për arsimimin e të rriturve

Pas pranimit të dokumenteve dhe shqyrtimit paraprak nga ana e IP Qendra për arsimimin e të rriturve, dokumentet i jepen Komisionit për verifikim, i cili sipas rregullores për mënyrën e verifikimit të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve, përbëhet se paku nga tre anëtarë: një anëtar nga Qendra për arsimimin e të rriturve, një nga Qendra për arsim dhe trajnim profesional, shkolla apo universiteti dhe një person profesional nga lëmia e programit të paraqitur. Kryetar i komisionit është anëtari nga Qendra për arsimimin e të rriturve. Në afat prej 30 ditëve pas dorëzimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme, Komisioni e shqyrton dhe vlerëson programin.

Në këtë fazë IP Qendra për arsimimin e të rriturve, mund të kërkojë prej entit/institucionit për arsimimin e të rriturve, informata shtesë për entin/institucionin që do të realizojë programin e dorëzuar për verifikim. Enti/institucioni për arsimimin e të rriturve është i obliguar që t'i dorëzojë të gjitha informatat e kërkuara deri të IP Qendra për arsimimin e të rriturve në afatin e caktuar nga ana e IP Qendra për arsimimin e të rriturve.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE – SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

3.3. Miratim i vendimit të verifikim të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve

Në bazë të evaluimit të kryer për programin e veçantë dhe pas kontrollit të dokumenteve të tjera, kryetari i komisionit për verifikim përgatit raport për drejtorin e Qendrës, me të cilin propozon vendim në bazë të kërkesës për verifikim të programit të veçantë me të cilin mund që:

- të pranojë në përgjithësi kërkesën dhe programin e dorëzuar, ose
- të refuzoj në përgjithësi kërkesën dhe programin e dorëzuar;

Vendim në raport me kërkesën e parashtruar për verifikimin e programit të veçantë, sjell drejtori i Qendrës për arsimimin e të rriturve. Vendimi për verifikimin e programit të veçantë për arsimimin e të rriturve jepet në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjetëve. Pas pranimit të vendimit për verifikim të programit të veçantë, ofruesi i shërbimeve mund të filloj procedurën për patentim të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve. Pas marrjes së

patentës nga Ministria për arsim dhe shkencë, ai pajiset me të drejtën e regjistrimit të pjesëmarësve dhe mund të fillojë me realizimin e programit. Vendimin për verifikim të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve, e dorëzon Qendra për arsimimin e të rriturve, deri te Ministria për arsim dhe shkencë.

Enteve/institucioneve për arsimimin e të rriturve, kërkesa për verifikim të programeve të veçanta e cila është refuzuar nga Qendra për arsimimin e të rriturve, ju jepen sqarime më të detajuara për arsyet e refuzimit për verifikimin e programeve të veçanta. Programet e veçanta të cilat janë të verifikuara, regjistrohen në regjistrin e programeve të miratuara për arsimimin e të rriturve, të cilin e mban Qendra për arsimimin e të rriturve. Regjistri i programeve të miratuara për arsimimin e të rriturve, shpallet në faqen zyrtare të Qendrës për arsimimin e të rriturve.

3.3.1. Mbikëqyrje nga ana e IP Qendra për arsimimin e të rriturve dhe tërheqje të vendimit për verifikim të programit të veçantë

IP Qendra për arsimimin e të rriturve kryen mbikëqyrjen dhe evaluimin e jashtëm të realizimit të programit të veçantë të verifikuar, për arsimimin e të rriturve. Evaluimi i jashtëm do të kryhet sipas kriterëve të definuara të Qendrës për arsimimin e të rriturve dhe do të implementohet nga njerëz të autorizuar nga ana e Qendrës për arsimimin e të rriturve.

Raportet për monitorimin e realizimit të programeve të verifikuara për arsimimin e të rriturve, i përgatit Qendra për arsimimin e të rriturve. Ato bazohen në raportet e evaluimit të kryer të jashtëm, nga ana e Qendrës për arsimimin e të rriturve në hapësirat e entit/institucionit për arsimimin e të rriturve.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

Drejtori i Qendrës për arsimimin e të rriturve në bazë të informatave të marra, raportit për mbikëqyrje dhe raportit për evaluim të jashtëm dhe të brendshëm të realizimit të programeve të verifikuara të veçanta, mund të sjell vendim për tërheqjen/marrjen e verifikimit për programin e veçantë për arsimimin e të rriturve. Qendra për arsimimin e të rriturve duhet që t'i dorëzojë entit/institucionit sqarime më të detajuara për arsyet e tërheqjes së parakohshme të vendimit për verifikim të programit të veçantë.

Dy muaj para skadimit të verifikimit të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve, enti/institucioni për arsimimin e të

rriturve, i dorëzon Qendrës për arsimimin e të rriturve kërkesë për ri-verifikim të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve, i cili mund të gjendet në internet faqen e Qendrës për arsimimin e të rriturve, këtu gjendet edhe fletëpagesa për pagesën e realizuar të taksës për ri-verifikim të programit të veçantë, në llogari të Qendrës për arsimimin e të rriturve, në pajtim me çmimoren për ri-verifikim të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve, që miratohet nga ana e këshillit drejtues. Qendra për arsimimin e të rriturve, në rast se nuk ka vëretje ndaj kërkesës së dorëzuar, miraton vendim për verifikim të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve për 3 (tri) vitet e ardhshme.

3.3.2. Lajmërim të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve

Enti/institucioni për arsimimin e të rriturve pas pranimit të vendimit për verifikim të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve është i obliguar që deri te Qendra për arsimimin e të rriturve të dorëzojë raport vjetor për realizimin e evaluimit të programit. Për ndryshimet e ndodhura në realizimin e programit

të veçantë për arsimimin e të rriturve dhe qëllimet e programit më të mëdha se 20%, enti/institucioni për arsimimin e të rriturve duhet ta informojë Qendrën për arsimimin e të rriturve në afat prej 15 ditëve.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

4. Realizimi i programeve të veçanta të verifikuara për arsimimin e të rriturve

Entet/institucionet për arsimimin e të rriturve janë përgjegjëse për zhvillimin dhe realizimin e programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve. Entet/institucionet janë përgjegjëse për sigurimin e kualitetit dhe implementimit të standardeve të parashikuara për programet e veçanta të verifikuara për arsimimin e të rriturve nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë dhe nga Qendra për trajnim dhe arsim profesional.

Programet duhet të zhvillohen sipas nevojave të grupit të caktuar qëllimor, dhe duhet t'ju mundësojnë pjesëmarrësve të pajisen me njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e parapara. Pas marrjes së vendimit për verifikimin e programit për arsimimin e të rriturve, enti/institucioni mundet publikisht të informojë se programi është verifikuar në pajtim me rregullat dhe standardet e Ministrisë për arsim dhe shkencë, Qendrës për arsimimin e të rriturve dhe Qendrës për trajnim dhe arsim profesional.

5. Procesi i aplikimit dhe i plotësimit të kërkesës për verifikim edhe të modelit të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve

Para se të fillojë procesi i verifikimit, entet/institucionet për arsimimin e të rriturve duhet të njihen me procedurat dhe kriteret për verifikim të programeve të veçanta dhe të kontrollojnë se a thua i plotësojnë kriteret dhe standardet për kryerje të programeve të veçanta të verifikuara, për arsimimin e të rriturve, të parapara nga ana e Ministrisë për arsim dhe shkencë e R. së Maqedonisë, Qendrës për arsim të të rriturve dhe Qendrës për trajnim dhe arsim profesional.

Gajtë plotësimit të kërkesës për verifikim edhe të modelit të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve, duhet të përdoret gjuhë e kuptueshme, kurse kuptimet profesionale të sqarohen në mënyrë të saktë.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

5.1. Model i programit të veçantë për arsimimin e të rriturve

Të gjitha elementet e programit të veçantë për arsimimin e të rriturve plotësohen, kurse pjesët që nuk janë të domosdoshme janë të shënuara me yll *.

Modeli i programit të veçantë za për arsimimin e të rriturve (në tekstin e mëtutjeshëm programi model) përmban:

Informata të përgjithshme për entin/institucionin dhe të dhëna për kontakt (pika 1-6)

- 1) **Data e aplikimit:** datën, kur zyrtarisht është aplikuar në Qendrën për arsim të të rriturve për verifikim të programit të veçantë
- 2) **Emri i aplikuesit** (entit/institucionit për arsimimin e të rriturve)
- 3) **Numri i patentës së entit/institucionit për arsimimin e të rriturve (përderisa enti/institucioni ka patentë nga Ministria për arsim dhe shkencë e R. së Maqedonisë)**
- 4) **Emri dhe mbiemri i drejtorit:** Të shënohet emri dhe mbiemri i drejtorit (përfaqësuesit të autorizuar) të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve
- 5) **Të dhëna për kontakt:** Adresa, telefoni dhe adresa elektronike e entit/institucionit për arsimimin e të rriturve
- 6) **Të dhëna për kordinatorin e programit:** emrin dhe mbiemrin, pozitën, kualifikimin, telefonin për kontakt dhe adresën elektronike (e-mail) të kordinatorit të programit; Kordinatori i programit duhet të jetë person i cili është më i udhëzuar për të ofruar të dhëna të detajuara për programin e Qendrës për arsimimin e të rriturve

Informata për programin e veçantë për arsimimin e të rriturve dhe implementimi i tij (pika 7-24)

- 7) **Emri i programit.** Të shkruhet emri i programit për të cilin kërkoni verifikim. Rekomandohet emri i programit të jetë koherent, të reflektojë nivelin dhe përmbajtjen e programit, por edhe të jetë në pajtim me titullin e certifikatës.
- 8) **Përshkrim i programit.** Të jepet një përshkrim i shkurtër i programit: qëllimi kryesor i programit, mënyra e realizimit, deri të çfarë certifikate duhet të drejtojë, modulet e programit (nëse ka), kohëzgjatja, përparimi i programit në nivelet/llojet tjera të arsimit, si edhe të mundësojë kualifikim që lehtë njihet në tregun e punës.
- 9) **Profili i pjesëmarrësit në program.** Jepen informata për profilin e pjesëmarrësve të cilët pritet të marrin pjesë në program. Të theksohen sa më tepër informata që është e mundur, se çfarë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca duhet të posedojnë pjesëmarrësit potencial në program, nivelin e tyre arsimor dhe moshën.
- 10) **Numri i planifikuar i pjesëmarrësve në program.** Numri i pjesëmarrësve të planifikuar në program duhet të jetë në pajtim me kushtet didaktike, kadrovike dhe hapësinore-teknike të entit/institucionit. Në programin model theksohet edhe numri i planifikuar i pjesëmarrësve në program.
- 11) **Qëllimet e programit.** Duhet të definohen qëllime reale dhe të realizueshme, të cilat e pasqyrojnë programin. Qëllimet patjetër duhet të bazohen në standarde të caktuara të cilat duhet të arrihen pas mbarimit të programit.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE – SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

Qëllimet e programit duhet poashtu të jenë të lidhura me të dhënat në çertifikatë, t'i pasqyrojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat që duhen arritur, duhet të mund të maten dhe të mund të kontrollohet arritja e tyre në procesin e evaluimit (të brendshëm dhe të jashtëm) të programit dhe t'i pasqyrojnë nevojat e pjesëmarrësve.

- 12) Rezultatet arsimore të programit.** Në programin model duhet të përfshihen rezultatet arsimore. Rezultatet arsimore janë të dhëna me të cilat tregohet krejt çka duhet të dijë, të kuptojë dhe/ose të jetë në gjendje të demonstrojë pas mbarimit të programit, pjesëmarrësi. Gjatë formulimit të rezultateve arsimore me rëndësi është që të pasqyrohet aktiviteti i dëshiruar i pjesëmarrësit për të demonstruar njohuritë dhe shkathtësitë e përfituara. Bëhet fjalë për aktivitete të cilat do të maten, gjegjësisht rrjedhin edhe në bazë të asaj, se si, arsimtari/trajnesi do të vlerësojë të arriturat e nxënësit. Gjatë formulimeve shfrytëzoni aktivitete të qarta, të matshme të rezultateve arsimore. Folje të sakta për formulimin e rezultateve arsimore janë: analizon, përshkruan, definojnë, bën, krahasuar, dalluar, argumentuar etj.

Shembull: Pas kryerjes së programit, pjesëmarrësi do të jetë i aftë të bëjë me sa vijon:

- 13) Kriteret për hyrje në program.** Kriteret për hyrje duhet të jenë në pajtim me procedurat e sigurimit të cilësisë të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve dhe të jenë në pajtim më nivelin e programit, përmbajtjen, qëllimet e arsimit, por mos të paraqesin pengesa të panevojshme për hyrje në program.

- 14) Kohëzgjatja e programit.** Të shënohet numri i përgjithshëm i orëve të programit, numri i orëve në javë,

si edhe zgjatja e përgjithshme e programit në muaj/vjet. Nëse programi është modular, të theksohet kohëzgjatja e secilit modul një nga një. Kohëzgjatja e programit duhet të përgjigjet me strukturën dhe përmbajtjen e programit, profilit të pjesëmarrësve (a do të ketë kohë të mjaftueshme grupi qëllimor për mbarim të suksesshëm të programit), metodat e implementimit dhe evaluimit dhe rezultatet arsimore të parapara me programin.

- 15) Format e implementimit të programit.** Format e implementimit kanë të bëjnë me atë se si programi do të implementohet. Nga mundësitë e ofruara duhet të zgjidhet njëra ose më tepër forma: mësim në klasë/kabinet, mësim praktik, mësim në distancë, mësim elektronik ose mënyrë tjetër e implementimit. Format e implementimit duhet t'i përgjigjen profilit të pjesëmarrësit, rezultateve të arsimit nga programi, përvojës dhe kualifikimeve të kuadrit arsimor.

- 16) Metodot e arsimit.** Të numërohen metodat kryesore të cilat përdoren në procesin e implementimit të mësimi. Mund të zgjedhen disa mundësi ose të shtohen edhe tjera: arsimit i orientuar në klasë, diskutimet në grupe, mësimi praktik në punëtori/kabinet, mjedis simulativ i punës, mësim individual, mësim i pavarur, mësim i drejtuar kah zgjidhja e problemeve, vizita/udhëtime studimore, trajnim në vend të punës dhe metoda tjera në arsim. Metodot e zgjedhura duhet të jenë në përputhshmëri me nevojat e pjesëmarrësve, nivelin dhe përmbajtjen e programit dhe mënyrën e implementimit.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

17) Struktura e programit. Strukturën e programit e zhvillon enti/institucioni për arsimimin e të rriturve në pajtim me kriteret e miratuara për kualitet të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve. Struktura e programit duhet të jetë e ndarë në njësi më të vogla mësimore ose module dhe të jetë në pajtim me rezultatet e pritura arsimore nga programi dhe nevojat e pjesëmarrësve në program. Struktura e programit duhet të jep fotografi të qartë të qëllimeve programore ose moduleve, të cilat do të implementohen. Në programin model, duhet të theksohen edhe informatat rreth kontrollit të rezultateve të arritura nga mësimi.

18) Plani për kontrollin e rezultateve të arritura nga programi. Planifikimi i kontrollit të rezultateve të arritura arsimore nga programi, paraqet një pjesë majft të rëndësishme të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve. Ju rekomandohet enteve/institucioneve që aktivitetet, lidhur me kontrollin e rezultateve arsimore nga programi të jenë pjesë e integruar e tyre dhe të planifikohen pas secilës njësi më të madhe mësimore (kurse në rastet kur programi është modular, pas mbarimit të secilit modul) me qëllim që të vërtetohet përparimi i pjesëmarrësve në program dhe të vërtetohen rezultatet e arritura arsimore në fund të programit. Në programin model të ceket kur/në cilën pjesë të programit është planifikuar kontrolli i asaj që është mësuar, cilat teknika do të përdoren, kriteret e kontrollit dhe mënyra e vlerësimit, koha e nevojshme për kontrollim të jetë e theksuar në minuta. Kontrolli i rezultateve të arritura arsimore duhet të ju mundësojë pjesëmarrësve në program, mundësi të mjaftueshme për sukses, me qëllim që të ju mundësoj përparim dhe kalim në program ose modul tjetër, para se të mbarojë programi.

19) Përdorimi i standardeve të profesioneve. Standardi i profesioneve është dokument për përcaktimin e llojit të profesionit, nivelin dhe kërkesat e punës dhe njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e nevojshme. Në programin model, duhet të qartësohet se ku gjatë përgatitjes së programit janë përdorur standardet e profesioneve (nëse janë përdorur) dhe ku përputhen ato me përmbajtjen, rezultatet e planifikuara dhe kriteriumet për kontroll të rezultateve të arritura të programit. Për informata shtesë, entet/institucionet për arsimimin e të rriturve duhet të drejtohen deri të Qendra për trajnim dhe arsim profesional, institucion ky që është adekuat për përgatitjen e standardeve për profesione.

20) Vetëvlerësim/evaluim i brendshëm. Vetëvlerësimi kryhet nga ana e entit/institucionit, i cili e implementon programin dhe ka për qëllim përmirësimin konstant të cilësisë të programit në pajtim me nevojat e pjesëmarrësve. Vetëvlerësimi duhet të implementohet në mënyrë të vazhdueshme dhe në bazë të kriterëve të definuara nga ana e Qendrës për arsimimin e të rriturve. Në programin model duhet të theksohet se çfarë masash do të ndërmerren pas rezultateve të fituara nga vlerësimi i brendshëm.

21) Kuadri arsimor. Kualifikimet dhe përvoja e punës së kuadrit arsimor duhet të jenë në përputhje më përmbajtjen, me rezultatet e pritura të programit, profilin e pjesëmarrësve, format dhe metodat e implementimit të mësimit. Sipas nenit 21 nga Ligji për arsimimin e të rriturve (Gazeta zyrtare e R së Maqedonisë nr. 7/08),



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

në programin model duhet të ceket numri i kuadrit arsimor, i planifikuar për realizimin e programit, kualifikimet e tyre, kualifikimet andragogjike, përvoja e punës, si edhe obligimet dhe aktivitetet në ent/institucion, si dhe jashtë tij.

22) Përkrahje për pjesëmarësit. Pjesëmarësve në program duhet t'ju mundësohet përkrahje në pajtim me programet dhe procedurat, për sigurim të cilësisë, të entit/institucionit për arsimimin e të rriturve. Përkrahja e pjesëmarësve duhet të sigurohet nëpërmjet kuadrit të kualifikuar dhe masave të veçanta, si për shembull: përkrahje individuale ose kolektive për sfera dhe lëndë të caktuara, konsultime dhe shfrytëzim të punëtorive jashtë procesit të mësimi, bibliotekës, shfrytëzim të pajisjeve kompjuterike dhe internetit etj. Në formular duhet të ceket, cilat janë masat dhe aktivitetet e parapara për përkrahje të pjesëmarësve në program.

23) Pajisje dhe mjete ndihmëse mësimore. Pajisjet dhe mjetet ndihmëse mësimore duhet të jenë adekuate ndaj numrit dhe profilit të pjesëmarësve, përmbajtjes së programit, rezultateve të pritura arsimore të programit, formave dhe metodave të mësimi në realizimin e programit. Në formular duhet të ceket pajisjet dhe mjetet ndihmëse mësimore, të cilat do të jenë në dispozicion të pjesëmarësve gjatë kohës së realizimit të programit.

24) Masat për mbrojtje dhe siguri. Gjatë implemetimit të programit, duhet të implementohen masat dhe aktivitetet për mbrojtje dhe siguri për pjesëmarësit në program, varësisht nga përmbajtjet e programit. Në formular theksoni masat e planifikuara për mbrojtje dhe siguri të pjesëmarësve të programit.

25) Financimi i programit. Theksoni burimet e financimit të programit. Për shembull, mjetet nga buxheti shtetëror ose lokal, donatorë të vendit ose të jashtëm, kompani, pjesëmarës ose të tjerë.

26) Ente/institucione të tjera. Në formular theksoni entet/institucionet të cilat do të jenë të involvuara në program, si edhe rolin e tyre në realizimin e të njëjtit.

27) Vendi i implementimit të programit. Përmendni vendin/vendet dhe adresën ku do të realizohet programi.

28) Deklaratë. Me deklaratën drejtori

- e vërteton saktësinë e informatave të përfshira në formular;
- vërteton se formulari është plotësuar në pajtim me Doracakun për verifikim të programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve;
- vërteton se janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme për realizim të programit;
- dakordohet që të kryhet mbikëqyrje nga institucionet përkatëse.

29) Emri dhe mbiemri i drejtorit, nënshkrimi dhe vula entit/institucionit



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

6. Shtojca

6.1. Shtojca 1: Definimi i termave (sipas ligjit për arsimimin e të rriturve në R. e Maqedonisë dhe terminologjinë e CEDEFPP1¹):

Verifikimi i programeve arsimore	Është proces i sigurimit të kualitetit, duke siguruar verifikimin e programit edukativ, i cili verteton se programi është i kontrolluar nga institucionet relevante profesionale sipas rregullave ligjore dhe i plotëson standardet e përcaktuara.
Mësimi gjatë gjithë jetës	Të gjitha aktivitetet arsimore të ndërmarra gjatë gjithë jetës, rezultojnë në përmirësimin, e njohurive, aftësive, kompetencave dhe/ ose kualifikimeve për zhvillimin personal, social dhe profesional.
Arsim joformal	Mësimi që rezulton nga aktivitetet e përditshme që lidhen me familjen, punën ose kohën e lirë. Kjo nuk është e organizuar apo strukturuar në drejtim të objektivave të kohëzgjatjes, dhe mbështetjen e procesit arsimor. Të mësuarit informal në shumë raste është pa dashje nga pjesëmarrësi.
Kualifikim	Dokumenti (zakonisht i quajtur “çertifikatë” ose “diplomë”), i lëshuar nga një organ i autorizuar që deklaron se individi ose e ka kryer programin arsimor, ose ka arritur një nivel të caktuar të kompetencës në një profesion të caktuar.
Kompetencat kryesore	<ol style="list-style-type: none">1) Komunikim në gjuhën amëtare2) Komunikim në gjuhën e huaj3) Kompetenca numerike dhe kompetenca themelore nga lëmia e shkencës dhe teknologjisë4) Kompetenca digjitale5) Mësim racional6) Kompetenca sociale dhe qytetare7) Kompetenca ndërmarëse8) Vetëdije kulturore dhe shprehëse



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË RRRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

¹ CEDEFOP: European guidelines for validating non-formal and informal learning, Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg 2009

Kompetenca	Aftësia që rezultatet arsimore të përdoren në mënyrë adekuate në kontekstin e definuar (arsimor, në vendin e punës, të zhvillimit personal ose profesional).
Mësimi në distancë	Arsimi apo trajnimi i përcjellë përmes mediave të komunikimit në distancë: libra, radio, televizion, telefon, korrespondencë, kompjuter ose video.
Mësues në arsimimin e të rriturve	Personi i cili ka statusin e një mësuesi në arsimimin e të rriturve në bazë të rregullave ligjore dhe/ose praktikën në një vend të caktuar.
Arsimi joformal	Edukimi i cili përfshin aktivitetet e planifikuara të cilat nuk janë në mënyrë eksplicite të etiketuara si mësim (në kuptimin e objektivave arsimore, kohëzgjatja apo mbështetje për të mësuarit). Arsimi joformal zhvillohet me qëllim të pjesëmarrësve në arsim.
Arsimimi i të rriturve	Tërësia e aktiviteteve arsimore në arsimimin formal, joformal dhe informativ, të ndërmarra nga të rriturit, pas një ndërprerjeje të arsimit dhe trajnimit fillestar dhe që rezultojnë në marrjen e njohurive, dhe aftësive të reja. <i>Vërrejte:</i> Kjo përfshin edhe arsimimin e lartë universitar në qoftë se është nisur pas një ndërprerjeje të përfundimit të arsimit dhe trajnimit fillestar.
Rezultatet arsimore	Rezultatet arsimore janë deklarata që shprehin atë që pjesëmarrësit duhet të dinë, të kuptojnë dhe/ose të jetë në gjendje të demonstrojë pas përfundimit të programit.
Trajnim në vendin e punës	Trajnimi profesional i kryer në situatë normale të punës. Mund të jetë e përbërë vetëm nga trajnimi në vendin e punës ose trajnim i kombinuar që do të mbahet në vendin e punës.
Trajner në arsimimin e të rriturve	Personi i cili punon me pjesëmarrës të rritur në marrjen e njohurive praktike ose të aftësive, dhe ekspertiza e të cilit nuk është fituar domosdoshmërisht nëpërmjet kualifikimeve formale.
Kualifikimet e pjesërishme	Pjesa e kualifikimit që përfitohet me programet që organizohen për të zhvilluar, plotësuar.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË RRRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

Njohja e rezultateve arsimore	Njohja e rezultateve arsimore: Konfirmimi nga institucioni apo organi relevant, se rezultatet ishin të vërtetuara (njohuritë, aftësitë dhe/ose kompetencat), që një person ka fituar në kontekstin formal, joformal ose informativ, sipas kritereve të vendosura dhe se ata i përmbushin standardet e përcaktuara për njohjen. Njohja zakonisht dërgon në çertifikim.
Korniza e kualifikimeve	Instrumenti i zhvillimit dhe i klasifikimit të kualifikimeve (p.sh. në nivel kombëtar ose sektorial) sipas kritereve (për shembull duke përdorur përshkruesit) të zbatueshme në disa nivele të caktuara të rezultateve arsimore.
Çertifikatë	Çertifikata është një dokument që konfirmon përfundimin e një programi të të vecantë arsimor për të rritur.
Çertifikimi	Çertifikimi i rezultateve arsimore: proces me të cilin formalisht vërtetohen se rezultatet e caktuara arsimore (njohuritë, aftësitë dhe / ose kompetencat) që një person ka fituar, janë vlerësuar dhe njohur nga institucioni përkatës në përputhje me standardet e përcaktuara më parë. Çertifikimi çon në lëshimin e një çertifikatë, diplomë ose titulli.
Standardi i profesionit	Standard i profesionit është një dokument për përcaktimin e llojit të profesionit, nivelin dhe kërkesat në punë dhe kompetencat e nevojshme, njohuritë dhe aftësitë.
Kualifikim profesional	Punë ose kualifikim profesional për kryerjen e një profesioni të caktuar ose pjesë e profesionit e cila fitohet në bazë të pjesëve të verifikuara të programit arsimor.
Arsimim profesional dhe trajnim	Arsimimi dhe trajnimi që kanë për qëllim t'ju mundësoj njerëzve njohuri, aftësi dhe/ ose kompetenca të duhura në një profesion të veçantë ose treg më të gjerë të punës.
Enti/institucioni për arsimimin e të rriturve	Individ ose organizatë që kryen veprimtari arsimore për të rriturit.



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE – SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

Pjesëmarrës në arsimimin e të rriturve	Pjesëmarrës është një person që është i përfshirë në programet arsimore për të rriturit, dhe paraprkishtë i ka plotësuar kushtet në lidhje me arsimimin e mëparshëm të detyrueshëm si dhe persona të tjerë që arsimohen, dhe nuk kanë statusin e nxënësit.
Arsimim formal	Arsimimi që zbatohet në një mjedis të organizuar dhe të strukturuar (p.sh., në institucion arsimor, ose të trajnimit ose në një vend pune) dhe është përcaktuar në mënyrë eksplicite si mësim (në lidhje me qëllimet, kohëzgjatjen dhe resurset). Arsimitimi formal bëhet me qëllim që pjesëmarrësit zakonisht i dërgon në verifikimin dhe çertifikim.

6.2. Shtojca 2: Modeli i një programi të veçantë për arsimimin e të rriturve në qendrën për arsimimin e të rriturve

Të gjitha elementet e modelit të programit të arsimimit të veçantë për të rriturit duhet të jenë të plotësuara, me përjashtim të atyre që nuk janë të domosdoshme dhe janë të shënuara me një simbol yll (*).

INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR ENTIN/INSTITUCIONIN PËR ARSIMIMIN E TË RRIURVE			
1.	Data e aplikimit		
2.	Emri i entit/institucionit për arsimimin e të rriturve		
*3.	Numri i patentës së entit/institucionit për arsimimin e të rriturve		
4.	Emri dhe mbiemri i drejtorit		
5.	Të dhënat për kontakt	Adresa: Numri i telefonit: Adresa e postës elektronike:	



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË RRIURVE – SHKUP



Unitet Nations
Development Programme



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE – SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

6.	Të dhënat për koordinatorin e programit	Emri dhe mbiemri: Pozita e punës: Kualifikimi: Numri i telefonit: Adresa e postës elektronike		
7.	Emri i programit			
8.	Përshkrimi i programit			
9.	Profili i pjesëmarrësit në program			
10.	Numri i planifikuar i pjesëmarrësve në program			
11.	Qëllimet e programit			
12.	Rezultatet e programit			
13.	Kriteret për hyrje në program			
14.	Kohëzgjatja e programit		Numri i përgjithshëm i orëve	
		Teori		
		Praktikë		
		Vlerësimi		
		<u>Informata të tjera:</u> Numri i orëve në javë: Kohëzgjatja e programit në muaj/: Komente plotësuese:		

15.	Format e zbatimit të mësim	Format e zbatimit	Vërrejtje			
		Mësim në klasë/kabinet				
		Mësim praktik				
		Mësim elektronik				
		Mësim në distancë				
16.	Metodat në mësim	Metoda	Vërrejtje			
		Mësim ballor (leksion)				
		Debat në grupe				
		Mësim praktik në punëtori/kabinet				
		Të mesuarit nëpërmjet simulimeve				
		Mësim individual				
		Mësim i vetëdrejtuar				
		Mësim i drejtuar kah zgjidhja e problemit				
		Vizita/udhëtime studimore				
		Trajnim në vendin e punës				
		Të tjera (specifiko):				



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

17.	Struktura e programit Vendos module(njësi tematike) në program	Emri i modulit	Përshkrimi	Statusi	Kohëzgjatja (orë)	Mënyra e vlerësimit
				E domos- doshme E zgjedhur		Provim me gojë Teste Përmbledhje e të arriturave Punë më shkrim Portofolio Prezentim praktik E të tjerë
18.	Kontrollimi i rezultateve	Periudha e notimit	Mënyra e vlerësimit		Kriteret për vlerësim	Kohëzgjatja e vlerësimit (min.)
*19.	Standardet e profesioneve					
20.	Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm	Mjetet/metodat (pyetje, diskutime, raporte për vlerësimin e kryer) Kohëzgjatja: A planifikoni të zbatoni disa masa mbi bazën e rezultateve të fituara gjatë vlerësimit				



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

21.	Kuadri mësimor	
*22.	Mbështetje për pjesëmarrësit	
23.	Pajisjet dhe pajisjet ndihmëse mësimore	
*24.	Masat për mbrojtje dhe siguri	
*25.	Financimi i programit	
*26.	Ente/institucione tjera	



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE - SHKUP



Unitet Nations
Development Programme

27.	Vendi i realizimit	
28.	Deklarata	<p>Unë i/e poshtënjshkruari/a:</p> <ul style="list-style-type: none"> – e komfirmoj saktësinë e informative të përfshira në formular – komfirmoj se formulari është plotësuar sipas doracakut për verifikimin e programeve të veçanta për arsimimin e të rriturve – komfirmoj se janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme për realizimin e programit – pajtohem që të monitorohet zbatimi i programit nga intitucioneve kompetente
29.	<p>Emri dhe mbiemri i drejtorit</p> <p>Nënshkrimi dhe vula e entit/ institucionit</p>	



IP QENDRA PËR ARSIMIN E TË
RRITURVE – SHKUP



Unitet Nations
Development Programme